



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1, 10¹ dhe 13 nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) nga Ligji për procedurën e përgjithëshme administrative („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.124/15), në lidhje me Propozimin PA1 nr.08-110 datë 7.3.2023 dhe Propozimin PA1 nr.08-110 datë 17.3.2023, dhe sipas Konkluzionit, ark.nr.02-1188/13 datë 21.3.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele në seancën e 11-të mbajtur më 21.3.2023, miratoi:

AKTVENDIM
për ndalim të procedurës si inicuar për heqje
të lejes për transmetim në radio

NDALOHET procedura e inicuar për heqjen e lejes për transmetim në radio ndaj Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive (SHTR) RADIO RED FM SHPKNJP Tetovë, nr.08-133 datë 5.1.2015.

A r s y e t i m

Këshilli i Agjencisë në seancën e 9-të mbajtur më 8.3.2023, me Konkluzion, ark.nr.02-1007/18 datë 8.3.2023, miratoi propozimin e drejtorit të Agjencisë, dr.Zoran Trajčevski, PA1 nr.08-110 datë 7.3.2023 dhe inicoi procedurë për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR RADIO RED FM SHPKNJP Tetovë, nr.08-133 datë 5.1.2015, për faktin se pas mbikëqyrjes së rregullt administrative, në Raportin me shkrim ark.nr.05-1024/1 datë 6.3.2023, është konstatuar se transmetuesi në afatin ligjor prej 30 (tridhjetë) ditësh nga dita e pranimit të faturës së lëshuar nga Agjencia, nuk ka përmbushur detyrimin nga neni 80 paragrafi (5) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, përkatësisht nuk ka paguar tarifën vjetore për leje për transmetim në radio Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Në lidhje me këtë, nga Agjencia më datë 9.3.2023 drejtuar transmetuesit të lartpërmendur i është dërguar Shkresë PA1 nr.08-110 datë 9.3.2023, për njoftim se nëse nuk paguan tarifën vjetore për lejen për transmetim në radio, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio.

Megjithatë, më 17.3.2023 drejtuar drejtorit të Agjencisë, nga Sektori i Financave dhe Logjistikë, është dorëzuar Njoftim aek.nr.05-1024/2 datë 17.3.2023 që SHTR RADIO RED FM SHPKNJP Tetovë, më 15.3.2023 ka kryer pagesë në shumë prej 11.195,00 (njëmbëdhjetë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e pesë) denarë dhe në 16.3.2023 ka kryer pagesë në shumë prej 8.581,00 (tetë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e një) denar, me të cilat transmetuesi e ka paguar plotësisht tarifën vjetore për lejen për transmetim në radio.

Уп1 Бр.08-110

Скопје 22.03.2023 г.



Агенција за аудио и
аудиовизуелни
медиумски услуги

ул. Македонија бр.38
1000 Скопје
Република Северна
Македонија

Тел. + 389 2 3103 400

www.avmu.org.mk
www.avmu.mk
contact@avmu.mk





REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA PËR SHËRBIME MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUELE

Rrjedhimisht nga sa më sipër, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafët 1, 10 dhe 13 nga Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në pajtim me nenin 54 paragrafi (4) dhe neni 104 paragrafi (4) nga Ligji për procedurën e përgjithëshme administrative, në lidhje me Propozimin PA1 08-110 datë 7.3.2023 dhe Propozimin PA1 nr.08-110 datë 17.3.2023, dhe sipas Konkluzionit ark.nr.02-1188/13 datë 21.03.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 11-të mbajtur më 21.03.2023, vendosi ndërprerjen e procedurës së inicuar për heqjen e lejes.

Bazuar në sa më lartë u mor vendim si në dispozitiv.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele,
Kryetari i Këshillit
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të vendimit.

¹ Nënparagrafët 8 dhe 9 fshihen, shiko: nenin 8 nga Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.248/18).